



Nr. 352

Dt. 12.10.2015

DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë dispozitave të nenit 24.2 dhe 24.5 të Ligjit Nr. 02/L-52 Mbi edukimin parashkollor, nenin 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 41/2007, dt. 9.10. 2007 Zbritja e tarifave që duhet të paguhen nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore, nenin 2, paragrafi 2.3 të Rregullores 01 nr. 110-157460, dt. 01.07.2014 Për të hyrat vetanake të Institucioneve Arsimore, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, drejtori i Drejtorisë për arsim publikon këtë:

NJOFTIM

I. Për lirim nga pagesa për fëmijët në Institucione Parashkollore për vitin shkollor 2015/2016.

Të drejtë lirimi nga pagesa kanë vetëm:

- Fëmijët e invalidëve të luftës lirohen nga pagesa 100%
- Fëmijët bonjakë (pa të dy prindërit) 100%;
- Fëmijët me nevoja të veçanta 100%
- Fëmijët në asistencë sociale 100%
- Fëmijët me njërin prind lirohen 50%;
- Prindërit që kanë më shumë se një fëmijë në IP të regjistruar, për një fëmijë do ta paguaj tarifën e plotë, për fëmijën e dytë lirohet 30%, për fëmijën e tretë lirohet 50% nga tarifa aktuale (kjo kategori mund të aplikoj vetëm në një Institucion Parashkollor).

II. Të gjithë parashtruesit e kërkesave duhet ti paraqesin këto dokumente:

- Kërkesën për lirim nga pagesa për vitin 2015/2016
- Certifikatën e lindjes së fëmijëve
- Kopjen kontratës me IP

Invalidët e luftës duhet t'i paraqesin edhe:

- Vendimin origjinal (ose kopjen e vërtetuar të noteri) të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të pensionit për invalid të luftës;

Faqe 1 nga 2



Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta edhe:

- Vërtetimin zyrtar për fëmijën me nevoja të veçanta (vërtetimi nga HANDIKOS apo nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale).

Prindërit e fëmijëve në asistencë sociale edhe:

- Vërtetimin zyrtar që dëshmon periudhën aktuale që janë në asistencë sociale nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kujdestaret fëmijëve bonjakë (pa të dy prindërit) edhe:

-Certifikatën e vdekjes se prindërve (origjinale)

Prindi i vetëm pa bashkëshorte/bashkëshort edhe:

-Certifikatën e vdekjes së bashkëshortit/ës (origjinale)

Prindërit që kanë me shumë se një fëmijë të regjistruar ne çerdhet publike edhe:

-Certifikatën e lindjes të secilit fëmijë (origjinale) dhe fletëregjistrimin e tyre në institucionet përkatëse.

III. Lirimi nga pagesa, bëhet nga 1 shtatori i vitit 2015 deri 31 Gusht 2016.

Kërkesat dorëzohen në administratën e IP-së përkatëse.

Afati për paraqitjen e kërkesës është nga dt. 13.10.2015 deri me dt. 20.10.2015

Në publikimin e listës në tabelën e shpalljes në IP, **udhëzohet pala e pakënaqur se ka të drejt të paraqet ankesë për rishqyrtimin e vendimit të komisionit, në IP-në përkatëse, në afat prej tri (3) ditëve, jo në Drejtorinë e Arsimit.**

Palët e pakënaqura me përgjigjen e IP-së, mund të bëjnë ankesë në DKA, si shkallë e dytë në afat prej tetë (8) ditëve. DKA nuk shqyrton asnjë ankesë nëse e njëjta fillimisht nuk është paraqitur në IP-në përkatëse.

Vërejtje: Te gjitha dokumentacionet e pakompletuara, dhe jashtë afatit zyrtar të paraparë në këtë njoftim nuk do të shqyrtohen.

13 tetor 2015

Drejtor
Arbërie Nagavci
Arbërie Nagavci



Faqe 2 nga 2